



PSH.nr.801/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Efa Dienstleistung” Gmbh-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Schafberger Jr” Gmbh-Glllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve në QKMF dhe QKMU” me nr. të prok: 616-20-1939-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, më datën: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Efa Dienstleistung” Gmbh-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve në QKMF dhe QKMU” me nr. të prok: 616-20-1939-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

II. VERTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve në QKMF dhe QKMU” me nr. të prok: 616-20-1939-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Efa Dienstleistung” Gmbh-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SYETIM

Operatori ekonomik ankues “Efa Dienstleistung” Gmbh-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 12.10.2020 me nr. 801/20 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori ekonomik: “Schafberger Jr” Gmbh-Glllogoc , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve në QKMF dhe QKMU” me nr. të prok: 616-20-1939-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 10, 27, 59, si dhe nenin 60 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 26.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Efa Dienstleistung” Gmbh-Prishtinë

Përgjigje në pretendimin nr. 1, Lidhur me pretendimin e OE “Efa Dienstleistung” Gmbh, se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin në analizën financiare nuk ka paraqitur disa nga detyrimet sipas Ligjit të punës (nuk ka paraqitur detyrimet për pushimet mjekësore, që sipas OE ankues kjo kërkesë nuk është cekur në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se në formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 24.06.2020, ndër të tjera është kërkuar që kontraktori është i obliguar që të respektoj Ligjin e punës nr. 03/L-212, Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09 2017, ndërsa në dosje të tenderit janë specifikuar disa

detyrime që dalin nga ligji i punës (pagesa shtesë, ndërrimet e natës, festat shtetërore dhe pushimet vjetore) por nuk është specifikuar detyrimi për pushime mjekësore.

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosje të tenderit nuk është nënvizuar detyrimi i ligjit të punës për pushime mjekësore, ndërsa sa i përket kostos së pushimeve mjekësore konsideroj që është një kategori hipotetike e koston sepse nuk dihet numri i punëtorëve që do të marrin pushim mjekësor. Eksperti shqyrtues sqaron se as OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar kosto për pushime mjekësore, andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE “Efa Dienstleistung” GmbH, se AK ka eliminuar ofertën me arsyetimin se në analizën financiare nuk ka kalkuluar përvojën e punës konform dokumentit “Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” të publikuar më datë 06.07.2020, që sipas OE ankues kalkulimi i tyre në analizën financiare është bazuar në versionin i fundit të dosjes së tenderit të datës 09.07.2020 (pas datës së formularit të korrigjuar) dhe kalkulimi i bërë bazuar në versionin e fundit të dosjes së tenderit është konform LPP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK me datë 06.07.2020 në e-prokurim ka publikuar “Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” në të cilën tek pika 6 e kapacitetit teknik dhe profesional është ndryshuar dosja e tenderit. Në vend të:

Deklarata me shkrim të nënshkruar nga Ofertuesi për pagën Bazë 250 € bruto. OE është i obliguar që të punësoj 63 higjenistë, nga të cilët 38 jena punëtoresh ekzistuese të AK-së. Pagesa mujore totale për përvojën e punës për 38 të punësuar është në shumë 796.80 euro (pa TVSh).

Është: Deklarata me shkrim të nënshkruar nga Ofertuesi për pagën Bazë 250 € bruto. OE është i obliguar që të punësoj 63 higjeniste, nga të cilët 38 jena punëtoresh ekzistuese të AK-së. Pagesa mujore totale për përvojën e punës për 38 të punësuar është në shumë 850.00 euro (pa TVSh).

Ndërsa me datë 09.07.2020 pas publikimit të Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara”, AK ka publikuar në e-prokurim dosjen e tenderit e cila është e pandryshuar dhe nuk i ka përfshirë korrigjimet e publikuara.

Eksperti shqyrtues sqaron se dosja e publikuar e datës 09.07.2020 është e datës 10.06.2020, që nënkupton dosja fillestare e tenderit që është publikuar para korrigjimeve të bëra përmes “Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk duhet të merret si versioni i fundit i dosjes së tenderit, sepse AK ka bërë disa korrigjime dhe ka njoftuar OE në e-prokurim për korrigjimet e bëra.

Më poshtë gjeni dosjen e tenderit e publikuar me datë 09.07.2020 (version i fundit) e cila nuk ka ndryshuar asgjë dhe mban datën fillestare të dosjes së tenderit 10.06.2020.

DOSJA E TENDERIT PËR

KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBIM

Me Një Operator Ekonomik

Sipas Nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

PROCEDURË E HAPUR

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit:

10.06.2020

Pretendimi i OE ankues se si version i fundit duhet të merret dosja e tenderit e publikuar me datë 09.07.2020 për ekspertin shqyrtues është i paqëndrueshëm sepse kjo dosje mban datën 10.06.2020 të dosjes fillestare dhe vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet konform korrigjimeve të publikuara në e-prokurim.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues tek kërkesa 6. e kapacitetit teknik dhe profesional ku në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të punësoj 73 punëtorë, ndërsa në "Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara" numri i punëtorëve është ndryshuar në 63, dhe OE ankues në analizën financiare ka kalkuluar numrin prej 63 punëtorëve që d.m.th nuk është bazuar në dosje të tenderit (si version i fundit) por ka marrë për bazë numrin e punëtorëve që është publikuar në "Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara" që nënkupton se për një kriter të caktuar është bazuar në Dosje të tenderit, ndërsa për kriterin tjetër në "Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara". Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër se kalkulimet e analizës financiare nga OE ankues nuk janë bërë ndaras siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar një analizë të detajuar e cila është e ndarë në kolona për secilin lloj të kostove ku janë të prezantuara totalët e shpenzimeve për secilin shpenzim konform kërkesës së dosjes së tenderit, andaj eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me lidhjen e kontratës

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 26.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 28.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përgjigje në ekspertizë me nr 801/20

Ekspertiza për ankesën numër 801/2020 të datës 12/10/2020 aktiviteti i prokurimit numër 616-20-1939-2-1-1, ekspertiza e datës 26/10/2020 numër 801/2020.

Të nderuar panel i Organit Shqyrtues të Prokurimit, i nderuar ekspert shqyrtues

Më datën 26/10/2020 kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të ankesës sonë ku ne mendojmë se pretendimet tona kanë bazë të qartë ligjore dhe nisur nga dispozitat ligjore primare dhe sekondare ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Oferta jonë është shpallur nga autoriteti kontraktues si oferta e papërgjegjshme me disa arsye të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore dhe si të tilla i kemi parashtruar në ankesën tonë. Arsye të cilat nuk qëndrojnë asnjëra.

Pretendimi ankimorë që kemi paraqitur në ankesë

Ne kemi kalkuluar përvojën e punës sipas dosjes së tenderit të datës 09/07/2020 ku përvoja e punës fundit është në shumën prej 796.80 dhe për këtë çështje jemi deklaruar. Nisur nga dispozitat e LPP-së dhe aktet tjera ligjore ku thuhet se:

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron sqarimin e dispozitave të LPP-së dhe të legjislacionit dytësor si në vijim: Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 27 të LPP-së, Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë duhet të jenë identike. Gjithashtu, Në përputhje me nenin 18.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Si rrjedhojë, paragrafi 4 i nenit 27 të LPP-së si dhe neni 18.4 i RRUOPP detyrimisht kërkojnë që Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë të jenë identike, për faktin se një mospërputhje e kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit (Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë) si në rastin konkret do të përbënte mos respektim të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor të përmendura më lartë, si dhe mos respektim të parimeve themelore të prokurimit publik (barazia në trajtim jo diskriminimi, konkurrenca dhe transparenca).

Për të gjithë operatorët ekonomik që pretendojnë se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, si dhe në përputhje me dispozitat e LPP dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me

këtë ligj, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'atkuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së). Nisur nga të thënat ligjore si është e mundur të thuhet se për mendimin e ekspertit pretendimi ankimore është I pa bazuar ku ne duke pasur parasysh këto të thëna kemi ofertuar duke u bazuar në dosjen e tenderit e cila ishte akti i fundit i paraqitur si korrigjim gjatë fazës para tenderuese dhe si e tillë dosja konsiderohet si akti kryesor në një çështje tenderuese.

Mendimi i ekspertit i dhënë për këtë çështje, eksperti shqyrtues sqaron se dosja e publikuar e datës 09.07.2020 është e datës 10.06.2020 që nënkupton se është dosja fillestare e publikuar para korrigjimeve të bëra përmes Formularëve standard për korrigjimin e gabimeve dhe për mendimin ekspertit shqyrtues nuk duhet të merret si version i fundit i dosjes së tenderit, sepse AK ka bërë disa korrigjime që janë të datave para datës 09.07.2020. mendimi i juaj bie në kundërshtim më të thënat ligjore më lartë. Po, sikur ne të i referoheshim akteve të tjera korrigjuese dhe oferta jonë do të ishte më çmim më të lartë "si do të ishte vendimi AK, apo mendimi i ekspertit shqyrtues në këtë rast" apo do të vlerësohej sipas tekeve.

Dosja nuk mund të konsiderohet e identike sepse tek FDT kërkesat lidhur me makineritë dhe pajisjet të tjera, është e ndryshuar forma për dëshminë e pajisjeve të tilla nga AK. Që i bie se dosja nuk është identike këtë mund të shihni tek fq. 16. Eksperti shqyrtues nuk është lëshuar në elementet substanciale të ankesës sonë dhe arsyetimeve të cilat është eliminuar oferta jonë e cila është e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë. Sepse nëse në DT versionin e fundit është kërkuar një deklaratë e tillë atëherë qkuptim ka të merret për bazë një kriter i cili ka humb efektin e tij pas publikimit të versionit të ri të DT-së. Sa i përket këtij mendimi eksperti prapë nuk është bazuar në prova reale sepse:

Më poshtë gjëni dosjen e tenderit e publikuar me datë 09.07.2020 (version i fundit) e cila nuk ka ndryshuar asgjë dhe mban datën fillestare të dosjes së tenderit 10.06.2020.

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBIM

Me Një Operator Ekonomik

Sipas Nenit 27 të Ligjit Nr. 04 L-091 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 03 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092


PROCEDURË E HAPUR

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit:

10.06.2020

Pretendimi i OE ankues se si version i fundit duhet të merret dosja e tenderit e publikuar me datë 09.07.2020 për ekspertin shqyrtues është i paqëndrueshëm sepse kjo dosje mban datën 10.06.2020 të dosjes fillestare dhe vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet konform korrigjimeve të publikuara në e-prokurim. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues tek kërkesa 6.e kapacitetit teknik dhe profesional ku në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të punësoj 73 punëtorë, ndërsa në "Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara" numri i punëtorëve është ndryshuar në 63, dhe OE ankues në analizën financiare ka kalkuluar numrin prej 63 punëtorëve që dmth nuk është bazuar në dosje të tenderit (si version i fundit) por ka marrë për bazë numrin e punëtorëve që është publikuar në "Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara" që nënkupton se për një kriter të caktuar është bazuar në Dosje të tenderit, ndërsa për kriterin tjetër në "Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara".

Se ka dallim në versione të DT ne e kemi sqaruar se vërehet sipas DATËS SË HAPJES shih provat e bashkëngjitura:



Ku versioni i parë ka DATEN E HAPJES

Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar		Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: Po ☐ Jo ☒ <i>Nëse po, jep arsyetim:</i>
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do te bëhet me: 10.07.2020 në 14:00:00 orë Vendi: e-prokurimi
Përgjegjshmëria e tenderit dhe dhënies	29.3	

Dhe versioni i dytë ka DATEN E HAPJES

Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është: 13.07.2020 në 14:00:00 orë Vendi: e-prokurimi
--	------	--

Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar		Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: Po ☐ Jo ☒ <i>Nëse po, jep arsyetim:</i>
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do te bëhet me: 13.07.2020 në 14:00:00 orë Vendi: e-prokurimi
Përgjegjshmëria e tenderit dhe dhënies	29.3	

I nderuar panel pas vendimit të AK ne kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim për të cilën autoriteti nuk na është përgjigjur pretendimeve tona me arsyetimin se nuk e kemi paraqitur tersin e kërkesës. Gjë të cilën ne i jemi drejtuar me kërkesë IT “help deskut” në KRPP të cilën e kemi prezantuar në ankesën tonë. Ku thuhet se ne kemi parashtruar kërkesën tonë sipas afateve ligjore dhe të gjitha elementeve pretenduese ankimore. Ne kemi kërkuar raportin e vlerësimit për të parë se si është bërë vlerësimi i ofertave dhe atu shihet qartë se edhe komisioni ka vlerësuar ofertat ne bazën e kërkesave të dosjes së tenderit lidhur me përvojën e punës për të cilën është eliminuar oferta jonë.

Dhe absurditeti i tërë kësaj është se edhe AK edhe Eksperti bien ndesh me faktet reale të paraqitura në DT dhe raport të ekspertizës dhe të Vlerësimit të Tenderëve. Provë është Raporti i vlerësimit të AK-së i cili është bashkangjitur me ankesën tonë.

Edhe më të çuditshëm e bënë fakti se pasi që ne kemi kërkuar raportin e vlerësimit dhe në faqen 11 tek pika 6 thuhet

Dokumenti	Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë
-----------	--

Dokumenti	EfaDienstleistung GmbH – Dega në Kosovë
-----------	---

	Në pajtim / Nuk është në pajtim
6. Deklaratë më shkrim të nënshkruar nga Ofertuesi për pagën Bazë 250 € bruto. OE është i obliguar që të punësoj 63 higjeniste, nga të cilët 38 jena punëtore ekzistuese të AK-së. Pagesa mujore totale për përvojën e punës për 38 të punësuar është në shumë 796.80 euro (pa tvsh).	Në pajtim

Dhe raporti i Ekspertit ku thuhet

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Deklara të më shkrim të nënshkruar nga Ofertuesi për pagën Bazë 250 € bruto. OE është i obliguar që të punësoj 63 higjeniste, nga të cilët 38 jena punëtore ekzistuese të AK-së. Pagesa mujore totale për përvojën e punës për 38 të punësuar është në shumë 796.80 euro (pa tvsh).. Deklaratë se Paga 250 bruto bazë për punëtorët e angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë jo me pakse 250€ muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar që respektoj Ligjin e punës nr. 03 L-212, Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09 2017. Poashtu duhet të dorëzoj Deklaratën se pagat e punëtorëve do të paguaj me se largu me datën 05.10.2020 muajit vijues

Nëse bazohemi në parimet e drejtësisë në këtë mendim të ekspertit duke tentuar të thotë diçka që nuk është kërkuar nuk e konsiderojmë asgjë më shumë se fshehje e provave reale dhe mbetet në ndërgjegjen tuaj që ta cilësoni si veprim të drejtë ose jo.

Ne kërkojmë nga ju të nderuar që ta shqyrtoni hollësisht ankesën tonë dhe të shihni se elementet pretenduese të paraqitura janë në kundërshtim me LPP-në dhe aktet të tjera dytësore. Andaj, presim që vendimi juaj lëndën ta kthejë në ri-vlerësim dhe oferta jonë të shpallët e përgjegjshme.

Me respekt,

Administrata e kompanisë

Prishtinë 29 tetor 2020

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE “Efa Dienstleistung” GmbH, se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin në analizën financiare nuk ka paraqitur disa nga detyrimet sipas Ligjit të punës (nuk ka paraqitur detyrimet për pushimet mjekësore, që sipas OE ankues kjo kërkesë nuk është cekur në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 24.06.2020, ndër të tjera është kërkuar që kontraktori është i obliguar që të respektoj Ligjin e punës nr. 03/L-212, Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09 2017, ndërsa në dosje të tenderit janë specifikuar disa detyrime që dalin nga ligji i punës (pagesa shtesë, ndërrimet e natës, festat shtetërore dhe pushimet vjetore) por nuk është specifikuar detyrimi për pushime mjekësore. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit nuk është nënvizuar detyrimi i ligjit të punës për pushime mjekësore, ndërsa sa i përket kostos së pushimeve mjekësore konsideroj që është një kategori hipotetike e kostos sepse nuk dihet numri i punëtorëve që do të marrin pushim mjekësor. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se as OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar kosto për pushime mjekësore, andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE “Efa Dienstleistung” GmbH, se AK ka eliminuar ofertën me arsyetimin se në analizën financiare nuk ka kalkuluar përvojën e punës konform dokumentit “Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” të publikuar më datë 06.07.2020, që sipas OE ankues kalkulimi i tyre në analizën financiarë është bazuar në versionin i fundit të dosjes së tenderit të datës 09.07.2020 (pas datës së formularit të korrigjuar) dhe kalkulimi i bërë bazuar në versionin e fundit të dosjes së tenderit është konform LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK me datë 06.07.2020 në e-prokurim ka publikuar “Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” në të cilën tek pika 6 e kapacitetit teknik dhe profesional është ndryshuar dosja e tenderit. Në vend të:

Deklarata me shkrim të nënshkruar nga Ofertuesi për pagën Bazë 250 € bruto. OE është i obliguar që të punësoj 63 higjenistë, nga të cilët 38 jena punëtoresh ekzistuese të AK-së. Pagesa mujore totale për përvojën e punës për 38 të punësuar është në shumë 796.80 euro (pa TVSh).

Është: Deklarata me shkrim të nënshkruar nga Ofertuesi për pagën Bazë 250 € bruto. OE është i obliguar që të punësoj 63 higjeniste, nga të cilët 38 jena punëtoresh ekzistuese të AK-së. Pagesa mujore totale për përvojën e punës për 38 të punësuar është në shumë 850.00 euro (pa TVSh).

Ndërsa me datë 09.07.2020 pas publikimit të Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara”, AK ka publikuar në e-prokurim dosjen e tenderit e cila është e pandryshuar dhe nuk i ka përfshirë korrigjimet e publikuara. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se dosja e publikuar e datës 09.07.2020 është e datës 10.06.2020, që nënkupton dosja fillestare e tenderit që është publikuar para korrigjimeve të bëra përmes “Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk duhet të merret si versioni i fundit i dosjes së tenderit, sepse AK ka bërë disa korrigjime dhe ka njoftuar OE në e-prokurim për korrigjimet e bëra, ku versioni i dosjes së tenderit e publikuar me datë 09.07.2020 (version i fundit) e cila nuk ka ndryshuar asgjë dhe mban datën fillestare të dosjes së tenderit 10.06.2020 është bashkangjitur në raportin e ekspertit shqyrtues.

Pretendimi i OE ankues se si version i fundit duhet të merret dosja e tenderit e publikuar me datë 09.07.2020 është i paqëndrueshëm sepse kjo dosje mban datën 10.06.2020 të dosjes fillestare dhe vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet konform korrigjimeve të publikuara në e-prokurim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues tek kërkesa 6. e kapacitetit teknik dhe profesional ku në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të punësoj 73 punëtorë, ndërsa në ” Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” numri i punëtorëve është ndryshuar në 63, dhe OE ankues në analizën financiare ka kalkuluar numrin prej 63 punëtorëve që d.m.th nuk është bazuar në dosje të tenderit (si version i fundit) por ka marrë për bazë numrin e punëtorëve që është publikuar në ”Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara” që nënkupton se për një kriter të caktuar është bazuar në Dosje të tenderit ,ndërsa për kriterin tjetër në” Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara”. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër se kalkulimet e analizës financiare nga OE ankues nuk janë bërë ndaras siç është kërkuar në dosje të tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar një analizë të detajuar e cila është e ndarë në kolona për secilin lloj të kostove ku janë të prezantuara totalët e shpenzimeve për secilin shpenzim konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform neni 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim më të lirë nga të gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i

është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Prishtinë";
- 1x1 OE "Efa Dienstleistung" Gmbh- Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.